



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.2023

VENDIM

Nr. 364, Datë 13.07.2023

PËR

**ZGJATJEN E AFATIT TË CAKTIMIT NË SKEMËN E DELEGIMIT TË
GJYQTARIT Z. {...}**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 147, pika 1 dhe nenin 147/a, pika 1, shkronja “ë”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 61, pika 2, shkronja “a”, nenin 86, shkronja “ë” dhe nenin 97, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 45, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimin e tij nr. 22, datë 07.02.2019, “Mbi miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurën e funksionimit të skemës së delegimit të gjyqtarës”, si dhe në Vendimin e tij nr. 260, datë 15.07.2022, pas shqyrtimit të nevojave të sistemit gjyqësor dhe në funksion të mbarëvajtjes së tij, mbi propozimin e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

VENDOSI:

1. Zgjatjen e afatit të caktimit në skemën e delegimit të gjyqtarit z. {...} deri më datë 18.07.2026, afat që mund të ndërpritet ose zgjatet në varësi të rrethanave.
2. Efektet juridike të vendimit fillojnë nga data 18.07.2023.
3. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarit z. {...} sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në adresën postare elektronike zyrtare, si dhe Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR